

# Inspektori i Lartë i Drejtësisë

## BULETINI MUJOR

Nr.9

# Tetor 2021



## PUNA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË NË RAPORTIN E PROGRESIT TË SHQIPËRISË 2021

Më 19 Tetor 2021, Komisioni Evropian miratoi dhe publikoi Raportin e Progresit për Shqipërinë për vitin 2021, duke paraqitur një vlerësim të detajuar vjetor të progresit e reformave të kryera gjatë vitit të kaluar, si dhe rekomandimet e udhëzimet për prioritetet e reformave.

Në raport Komisioni ka bërë vlerësimin e punës edhe për institucionet e reja të drejtësisë, duke analizuar edhe punën e institucionit më të ri të dalë nga reforma në drejtësi, Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, për të cilin vlerëson se ka përmbushur plotësisht funksionet e tij gjatë

peridhës raportuese.

“Inspektori i Lartë i Drejtësisë (ILD) i ka kryer plotësisht funksionet e tij gjatë periudhës raportuese, vecanërisht duke filluar dhe kryer hetime disiplinore ndaj magistratëve. ILD-së i është dhënë staf, ambiente dhe buxhet shtesë.

Nevojitet ende rekrutimi i inspektorëve të tjerë, si dhe masa të targetuara për adresimin e stokut të çështjeve të patrajtuara, për t'i mundësuar ILD-së kryerjen e inspektimeve të rregullta tematike.”

Në progres raport evidentohet puna e kryer nga ILD gjatë periudhës së monitoruar, vitit 2020.



# ILD

INSPEKTORI I LARTË  
I DREJTËSISË

## STATISTIKA

“Gjatë periudhës së raportimit, ILD ka marrë 3054 ankesa, nga të cilat 1347 ishin të trashëguara nga Inspektoriati i mëparshëm. ILD ka trajtuar 173 ankesa dhe ka nisur tetë hetime disiplinore.

KLJGJ shkarkoi dy gjyqtarë bazuar në hetimet dhe kërkesat e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Kërkesa e ILD për masë disiplinore ndaj një prokurori u rrëzua nga KLP.”

# Ankimimi në ILD


Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë vijon me intensitet punën për konfirmimin e ankesave të mbartura e atyre të administruara që prej 1 Shkurtit 2020, kur u ngrit si institucion.

Për të lehtësuar këtë proces për personat e interesuar, ILD ka të publikuar në faqen zyrtare një formular të posacëm ankesë, i cili:

- ⇒ mund të plotësohet direkt dhe dërgohet online;
- ⇒ të shkarkohet, plotësohet e dërgohet me email në info@ild.al
- ⇒ ose me postë në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Godina nr.13, Tiranë.
- ⇒ Mund të plotësohet pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në rast nevojë, me asistencën e ekipit të zyrës së ankesave.

Pas marrjes së ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë Brenda 5 ditëve konfirmon me shkresë marrjen e saj.

Kriteret e pranueshmërisë së ankesës gjenden të publikuara në faqen zyrtare të ILD-së [www.ild.al](http://www.ild.al), në seksionin “Si pranohen ankesat”.



**“Angazhimi kryesor i institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është ushtrimi i funksioneve gjyqësore në Republikën e Shqipërisë në mënyrë sa më të pavarur, të paanshme dhe me integritet nëpërmjet një sistemi përgjegjshmërie dhe llogaridhënie.”**

## SEKTORI I ANKESAVE

Sektori i ankesave në ILD është përgjegjës për garantimin e të drejtës së informimit të qytetarëve dhe transparencën ndaj publikut. Ky sektor ndjek gjurmueshmërinë e ankesave në sistem dhe jep përgjigje për ankuesit, mbi fazën ku ndodhet ankesa e tyre.

Në kuadër të transparencës, për një komunikim të shtuar me qytetarët e interesuar, krahas faqes dhe adresës zyrtare, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka vënë në dispozicion numrin e telefonit +355 4 2217217.

## STATISTIKA

Gjatë muajit **Tetor**, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka administruar **99 ankesa** të cilat janë paraqitur nga qytetarë dhe institucione.

*Konkretisht:*

**89 ankesa** janë depozituar nga qytetarët;

**8 ankesa** janë përcjellë nga institucionet për kompetencë;

**2 ankesa** nga organizata vendase;

**33 telefonata** me qytetarë, të cilët kanë kërkuar informacion mbi fazën e ankesave të tyre ose informacion mbi plotësimin e formularit TIP të ankesës.

**18 takime** me ankues.



Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka kryer konfirmimin standard të marrjes së ankesës për të gjitha ankesat, që kanë hyrë për herë të parë në institucion, gjatë muajit Tetor 2021.

Ankesat që kanë subjekt të tyre prokurorë dhe gjyqtarë janë shpërndarë tek Inspektorët dhe ndodhen në faza të ndryshme, si shqyrtim fillestar, arkivim, verifikim, me projektvendimet përkatëse.

## METANI-HAXHIU: SHKËMBIM PËRVOJE PËR REFORMËN NË DREJTËSI NË KOSOVË



Inspektori i Lartë i  
Drejtësisë Artur Metani

priti në datën 5 Tetor Ministren e Drejtësisë së Kosovës, znj. Albulena Haxhiu dhe ekipin që e shoqëron gjatë vizitës zyrtare në vendin tonë. Bashkëbisedimi u fokusua tek reforma në drejtësi, një proces që ka nisur prej 5 vitesh në Shqipëri.

Z. Metani bëri një prezantim të Zyrës së ILD-së dhe punës si institucioni më i ri i dalë nga reforma në drejtësi, ndërsa znj. Haxhiu tha se Kosova është e interesuar të marrë nga Shqipëria përvojën për procesin e vettingut të magistratëve.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë shprehu gadishmërinë, në cdo rast që do i kërkohet, që të japë eksperiencën e punës së institucionit që drejton, c’ka u vlerësua pozitivisht nga Ministrja e Drejtësisë së Kosovës. Inspektori i Lartë i Drejtësisë Metani dhe Ministrja e Drejtësisë Haxhiu u dakordësuan që të mbajnë kontaktet për shkëmbim ekperience në këtë sfidë të re për Kosovën.

*“Ky është një proces që ne e kishim të domosdoshëm, tha z. Metani. Pavarësisht vështirësive e sfidave është një proces që ka sjellë sukses. Në këtë drejtim inkurajoj përpjekjet tuaja për reformimin e drejtësisë, edhe pse është një rrugë e gjatë dhe aspak e lehtë. Sot, prokurorët dhe gjyqtarët në Shqipëri, janë të mbrojtur me ligj e nuk ka mundësi të ndikohen nga askush, vetëm nëse e duan vetë një gjë të tillë.”*



## MASA DISIPLINORE MUND TË KTHEHET NË NDËSHKUESE PËR TË MBROJTUR INTERESIN PUBLIK

### KLJGJ PRANON KËRKESËN E ILD PËR SHKARKIMIN NGA DETYRA TË MAGJISTRATIT R.H.

Në datën 11 Tetor, Këshilli i Lartë Gjyqësor pranoi kërkesën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për masën disiplinore shkarkim nga detyra për gjyqtarin për magjistratin R.H., me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.



***“Masa disiplinore për një shkelje tepër të rëndë nuk mund të luajë më rol edukues, por merr përsipër mbrojtjen e interesit publik, duke u kthyer në një masë të pastër ndëshkuese, duke larguar nga detyra magjistratin nën hetim.”***

Kryetarja znj. Naureda Llagami njoftoi në TV Klan, c’ka coi në procedim dhe dënim vendimin, sipas të cilit KLJGJ në mënyrë penal ndaj magjistratit nga ish Gjykata e unanime vendosi shkarkimin nga detyra të Krimeve të Rënda. Veprimet e gjyqtarit kanë magjistratit. Në paraqitjen e rezultatit të cenuar veprimtarinë e rregullt të organeve hetimit disiplinor, Inspektori i Lartë i të drejtësisë nga veprimet e parregullta të Drejtësisë Artur Metani tha se veprimet e personave të jashtëm, por edhe nga R.H. kanë diskretitur rëndë figurën e veprimet e vetë atij si funksionar i gjyqtarit, imazhin e tij në publik, si dhe kanë drejtësisë. Kjo shkelje disiplinore sipas ulur besimin e publikut tek figura e gjyqtarit Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është aq e tek gjyqësori. Kjo pasi magjistrati ka rëndë sa e bën magjistratin të padenjë për të kërkuar e pranuar ryshfet në favor të tij dhe vazhduar funksionin e tij, e për pasojë masa disiplinore nuk mund të luajë më rol edukues, e ka përfituar atë për shkak të detyrës së tij, por merr përsipër mbrojtjen e interesit publik, si gjyqtar dhe në të njëjtën kohë ka kërkuar favor seksual nga një palë ndërgjyqëse, duke larguar nga detyra magjistratin dhe duke u transmetuar nga emisioni investigativ STOP kthyer kështu në masë me natyrë të pastër ndëshkuese ndaj tij.

## BESIMI I PUBLIKUT SI PJESË STANDARDEVE TË ETIKËS E SJELLJES SË MAGJISTRATËVE

### KLJ PRANON PJESËRISHT KËRKESËN E ILD PËR MASË DISIPLINORE NDAJ MAGJISTRATIT H.S.

KLJ pranoi pjesërisht kërkesën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për masë disiplinore ndaj gjyqtarit të Vlorës H.S.



Kryetarja Naureda Llagami tha se KLJ vendosi pranimin e pjeshëm të kërkesës së ILD-së, dhe caktimin ndaj magjistratit të masës “vërejtje publike”. Gjatë paraqitjes së konkluzioneve, Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani nënvizoi se i qëndronte propozimit, në bazë të hetimit disiplinor, për caktimin e masës “ulje page në masën 40% për 1 vit” për magjistratin H.S.

### ***“Besimi i publikut nuk është nocion i papërkufizuar, por se ai gjen mbështetje tek vlerat themelore dhe standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes së magjistratëve”***

Hetimi disiplinor ndaj magjistratit H.S., me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, u krye bazuar në praktikën e nisur ndaj magjistratit në vitin 2017 nga Inspektoriati i KLD-së dhe e përcjellë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Gjatë paraqitjes në KLJ të gjetjeve të hetimit disiplinor, Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani tha se në mënyrë të përsëritur magjistrati rezultoi të mos ketë zbatuar legjislacionin procedural e material, si dhe ta ketë zbatuar në mënyrë të gabuar, përmes vendimeve të konstatuara si të gabuara edhe nga një gjykatë më e lartë. Shkelje janë kryer në të paktën gjashtë vendime – objekt hetimi disiplinor, dhe pavarësisht vendimit të gjykatës më të lartë, e cila ka konstatuar këtë shkelje, magjistrati ka kryer të njëjtën shkelje dhe një herë tjetër, gjatë periudhës kohore 2020-2021, duke bërë që shkelja të jetë edhe vazhduese.

Shkeljet procedurale provohet të jenë kryer me dashje direkte, pasi rezultoi se magjistrati ka mbajtur një qëndrim konsequent deri më sot në të tilla raste, duke mos lëshuar urdhrin e ekzekutimit për aktet e dhënies së kredive bankare, ose aktet për dhënien e kredive nga institucionet financiare jobankare, nëse nuk janë akte noteriale.

Veprimet e kryera nga ana e magjistratit, kanë sjellë pasoja për dhënien e drejtësisë, kanë cënuar prestigjin e gjyqtarit, si dhe kanë cënuar besimin e publikut te drejtësia. Për këto arsye Inspektori i Lartë i drejtësisë i propozoi KLJ-së caktimin e masës disiplinore “Ulje e përkohshme e pagës deri në 40 % për një periudhë jo më të gjatë se një vit”.



## **THIRRJE PËR 9 POZICIONE TË LIRA PËR INSPEKTORË JO MAGJISTRATË**

---

**Je jurist me eksperiencë, me ambicie profesionale dhe me motivim për të kontribuar për shtetin e së drejtës në vendin tonë?**

**Eja e bëhu pjesë e ekipit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë!**

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka shpallur thirrjen për 9 (nëntë) pozicione për Inspektorë Jo-Magjistratë tek Njësia e Inspektorëve.

Inspektori kryen verifikime dhe hetime administrative rreth shkeljeve të pretenduara disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë.

Në ushtrimin e detyrës së tij, inspektori mbledh të dhëna dhe vlerëson çdo informacion, ose akt që çmon se është ose mund të jetë i rëndësishëm për zbatimin e detyrës, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative dhe ligjit nr. 96/2016, datë 06.10.2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Afati për dorëzimin e dokumentacionit është data 29 Tetor 2021.

Kushtet dhe kriteret si dhe dokumentacioni i kërkuar gjendet në linkun e mëposhtëm:

<https://ild.al/wp-content/uploads/2021/09/Shpallje-Inspektor-Jo-Magjistrate.pdf>

## Tetor 2021

Të gjitha të drejtat e rezervuara Inspektori i Lartë i Drejtësisë

© ILD



## KONTAKT ILD

WEB: [ild.al](http://ild.al)

EMAIL: [info@ild.al](mailto:info@ild.al)

ADRESA: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Godina nr.13  
Tiranë, Shqipëri



[Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani @ILD\\_Albania](https://twitter.com/ILD_Albania)

[YouTube Inspektori i Lartë i Drejtësisë](https://www.youtube.com/channel/UC...)



Spot prezantues ILD  
Prezantimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë  
[youtube.com](https://www.youtube.com)

[Kliko për të ndjekur spotin prezantues të ILD](#)